



Në bazë të nenit 12 të Vendimit mbi financimin e sportit (“Fletorja zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale” numër 032/19, 019/21) e në lidhje me konkursin publik për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive për vitin 2024, numër broj 04-614/24-1222/1 prej më 23.02.2024, e në propozim të Komisionit për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e vlerës së mjeteve për organizatat sportive, numër 01-614/24-3028/1 prej më 13.05.2024, kryetari i Komunës sjellë:

VENDIM

mbi shpërndarjen e mjeteve për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive për vitin 2024

I

Mjetet financiare në vlerë prej 36.000,00 €, të parapara për shpërndarjen e mjeteve sipas konkursit publik për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive për vitin 2024, numër 04-614/24-1222/1 prej më 23.02.2024, do tu shpërndahen organizatave si më poshtë:

N.r.	Emri i organizatës sportive	Selia e organizatës sportive	Shuma e mjeteve për bashkëfinancim
1.	Klubi i futbollit “Malësia 2010“	Tuz	14.000,00
2.	Klubi i futbollit “Tuz“	Tuz	7.600,00
3.	Klubi Taekwondo “Besa“	Tuz	7.500,00
4.	Klubi Taekwondo “Alba“	Tuz	2.400,00
5.	Klubi i Kërcimit “Tip toe”	Tuz	2.400,00
6.	Klubi i Xhudos “Deçiq”	Tuz	2.100,00
	Totali		36.000,00

II

Organizata sportive që nuk i plotëson kushtet për financim nga Buxheti i Komunës së Tuzit është:

N.r.	Emri i klubit sportiv	Selia e klubit sportiv
1.	Klubi i futbollit “Milesh”	Tuzi

Klubi i futbollit “Milesh” me seli në Tuz në baz të nenit 21 paragrafi 1 pika 4 e Rregullores mbi kushtet, mënyrën, procedurën, kriteret më të afërta për ndarjen e mjeteve dhe kontrollin e zbatimit të programit për organizatat sportive nr. 04-614/24-682/1 prej më 01.02.2024, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me Konkursin Publik për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive për vitin 2024.

III

Në bazë të këtij Vendimi do të lidhet kontrata mbi shfrytëzimin e mjeteve mbi bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive, mes organit të administratës

lokale kompetent për sport dhe personit të autorizuar të organizatës sportive, në të cilin do të precizohen të drejtat e veçanta dhe obligimet.

IV

Mjetet që i shpërndahen organizatës sportive për bashkëfinancimin e programit të punës mund të shpenzohen në pajtim me programin e miratuar.

V

Ku Vendim publikohet në web faqen dhe tabelën e njoftimeve të Komunës së Tuzit dhe iu dorëzohet pjesëmarrësve të konkursit. Vendimi i kryetarit është përfundimtar.

VI

Vendimi hynë në fuqi me ditën e sjelljes.

Arsyetim

Baza ligjore për sjelljen e këtij Vendimi mbështetet në nenin 12 të Vendimit mbi financimin e sportit („Fl. Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“ numër 032/19, 019/21) me të cilin është paraparë që kryetari i Komunës, në propozim të Komisionit sjellë Vendim mbi shpërndarjen e mjeteve për bashkëfinancimin e programit të organizatave sportive.

Sekretariati për vetëqeverisje lokale i Komunës së Tuzit, në pajtim me nenin 7 dhe 8 të Vendimit mbi financimin e sportit („Fl. Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“ numër 032/19, 019/21), me datë 23. shkurt 2024, ka shpallur konkurs publik me numër 04-614/24-1222/1 për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive për vitin 2024 nga Buxheti i Komunës së Tuzit. Konkursi publik është i shpallur përmes mediave të shkruara, në sajtin e komunës së Tuzit www.tuzi.org.me, në tabelën e lajmërimeve të komunës, si dhe në mediumin lokal TV Boin.

Të drejtë pjesëmarrje në konkurs kanë pasur klubet sportive, shoqëritë sportivo-rekreative, të cilat janë të regjistruara në territorin e Komunës së Tuzit, pas një viti nga dita e themelimit të atij klubit sportiv gjegjësisht shoqërisë sportivo-rekreative.

Në pajtim me nenin 10 të Vendimit mbi bashkëfinancimin e sportit (“Fletorja zyrtare e Malit të Zi- dispozitat komunale”, nr. 032/19, 019/21), kryetari i Komunës përmes Aktvendimit nr. 01-614/24-1222/2 prej më 06.03.2024 ka themeluar Komisionin për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e shumës së mjeteve për organizatat sportive për vitin 2024, me detyrën verifikim e dokumentacionit të arritur, ku në pajtim me dispozitat e Vendimit mbi financimin e sportit të Komunës së Tuzit dhe Rregullores mbi kriteret e hollësishme, mënyrën, procedurën e kriterëve për shpërndarjen e mjeteve dhe kontrollin mbi realizimin e programit të organizatave sportive, të përcaktojnë listen e renditjes së organizatave sportive të cilat plotësojnë gjegjësisht nuk i plotësojnë kushtet për financimin, të përgatisë Propozim Vendimin mbi bashkëfinancimin e programit të organizatave sportive dhe të njëjtin t’ia dorëzoi kryetarit të Komunës.

Me nenin 11 të Vendimit mbi financimin e sportit (“Fletorja zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, numër 032/19, 019/21) është paraparë që Komisioni pas vlerësimit të programit dhe përcaktimit të shumës së mjeteve për organizatat sportive ti dorëzoi kryetarit të Komunës propozimin e arsyetuar të vendimit për bashkëfinancimin e programit të organizatave sportive. Me paragrafin 2 të të njëjtit nen është paraparë që Propozim Vendimi për bashkëfinancimin duhet të përmbajë: emrin e organizatës sportive, selinë e organizatës sportive dhe shumën e mjeteve për bashkëfinancim.

Në bazë të nenit 7 paragrafin 1 i Rregullores mbi punën e Komisionit, Komisioni për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e shumës së mjeteve për organizatat sportive ka përcaktuar listën e renditjes të klubeve sportive të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me konkursin publik për vitin 2024, numër 01-614/24-2799/5 prej më 10.05.2024.

Në pajtim me nenin 7 paragrafin 5 të Rregullores mbi punën e Komisionit, Komisioni për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e shumës së mjeteve për organizatat sportive i ka dorëzuar kryetarit të Komunës propozimin e arsyetuar për bashkëfinancimin e programit të punës të organizatave sportive numër 01-614/24-3028/1 prej 13.05.2024.

Komisioni ka shqyrtuar paraqitjet e dorëzuar në pajtim me kushtet e cekura në Konkurs dhe kriteret e parapara sipas vendimit dhe rregullores, pas procedurës së kryer, ka përcaktuar listën e renditjes së organizatave sportive të cilat plotësojnë, gjegjësisht nuk plotësojnë për financim nga Buxheti i komunës së Tuzit, si dhe Propozimin e Vendimit i cili është publikuar në web faqen e Komunës së Tuzit e pjesëmarrësit e konkursit kanë pasur të drejtë që Komisionit ti dorëzojnë ankesë të arsyetuar në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit.

Komisioni për vlerësimin e programit dhe përcaktimin e shumës së mjeteve për organizatat sportive, në seancën e mbajtur më 10 maj 2024, në baz të nenit 21 paragrafi 1 pika 4 e Rregullores mbi kushtet, mënyrën, procedurën, kriteret më të afërta për ndarjen e mjeteve dhe kontrollin e zbatimit të programit për organizatat sportive nr. 04-614/24-682/1 prej më 01.02.2024 i cili përcakton se “Organizata sportive është e detyruar të bashkëngjisë Vertetimin se është anëtare e e shoqatës kompetente kombëtare sportive”, deklarohet në vijim:

- Se Klubi i futbollit “Milesh” me seli në Tuz nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me Konkursin Publik për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive për vitin 2024 për shkak të mungesës së posedimit të Vertetimin se është anëtare e e shoqatës kompetente kombëtare sportive.

Pas vështrimit dhe shqyrtimit të Propozim Vendimit, kryetari i Komunës ka sjellë vendim mbi shpërndarjen e mjeteve për bashkëfinancimin e programit të punës organizatave sportive për vitin 2024.

Në bazë të saj që është cekur është vendosur si në dispozitiv.

UDHËZIM PËR MBROJTJEN JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të paraqisni një ankesë në gjykatën administrative të Malit të Zi në afat prej 20 ditësh nga data e publikimit të vendimit.

Dorëzuar:

- Klubeve sportive;
- Sekretariatit për financa;
- Sekretariatit për vetëqeverisje lokale;
- a/a.



KRYETARI,
Lindon Gjellaj

GJELAJ